



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA  
ZYRA E AUDITORIT TË PERGJITHSHEM/KANCELARIJA GENERALNOG  
REVIZORA/OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL**

**Nr. i dokumentit 22.0.1-2008-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE TË  
KOMUNËS SË PRISHTINËS PËR FUND VITIN 31 DHJETOR 2008**

**Prishtinë, 31 Gusht 2009**

## **Tabela e përmbajtjes**

- I. Përmbledhje e përgjithshme
- II. Hyrje
- III. Gjendja e rekomandimeve nga vitet e kaluara
- IV. Fushëveprimi i auditimit
- V. Qasja e auditimit
- VI. Opinioni i auditimit
- VII. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit
- VIII. Dy llogaritë bankare të mirëbesimit

### Shtojcat:

- I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit (ISSAI 400)
- II. Komentet e Komunës dhe Vlerësimet e ZAP

## **Lista e shkurtesave**

AP	Auditori i Përgjithshëm
AK	Autoriteti Kontraktues
APP	Agjensioni për Prokurim Publik
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
K P	Komuna e Prishtinës
LMFPP	Ligji Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
LPP	Ligji Për Prokurimin Publik në Kosovë
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NPK	Ndërmarrja Publike Komunale
OE	Operatori Ekonomik
PF	Pasqyrat Financiare
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës
UA	Udhëzimi Administrativ
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

## I. Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP), ka kryer auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Prishtinës (Komuna) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008.

Auditimi jonë është kryer, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të hartuara, nga INTOSAI dhe ka përfshirë testet dhe procedurat që në mendim se ishin të nevojshme, për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Sipas mendimit tonë, Pasqyrat Financiare *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë*, në të gjitha aspektet materiale, pozitive financiare. (ISSAI 400 *Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes*). Si theksim të çështjes ne dëshirojmë të ju tërheqim vëmendjen në faktin se Komuna e Prishtinës nuk posedon regjistër final mbi pasuritë e saj (Ndërtesat, pajisjet dhe pasuritë tjera)

Auditimi i kryer ka rezultuar me të gjeturat dhe rekomandimet si në vijim:

1. Të hyrat nga shfrytëzimi i pronës publike (Parku i Gërmisë), nuk depozitohen në llogari të Thesarit, por kompensohen me punë të mirëmbajtjes së qytetit të Prishtinës;
2. Nuk bëhen harmonizime të të hyrave në mes të Drejtorisë së Financave dhe Drejtorive të tjera të cilët mbledhin të hyra, e as ndonjë harmonizim në mes kësaj Drejtorie, Bankave, dhe SIMFK;
3. Nuk është bërë evidentimi dhe vlerësimi i plotë i pasurisë së komunës;
4. Shpenzimet e karburanteve në vitin 2008 janë €1,094,659, respektivisht 35,7 % më shumë se vitin 2007. Komuna nuk ka të vendosur mekanizma adekuat të kontrollit të brendshëm për të evituar mundësinë e shpenzimit jo racional të karburanteve.
5. Shuma për kompensimet për punë jashtë orarit gjatë vitit 2008 ishin €337,163. Në krahasim me 2007 këto shpenzime janë rritur për 158% më shumë se në vitin 2008. Në lidhje me këto pagesa, Menaxhmenti i Komunës nuk ka ofruar dëshmi bindëse që do të justifikonin shpenzimet e ndodhura;
6. Subvencionet dhe Transferët nuk janë përdorur sipas rregullave financiare. Një shumë prej €80,000 është ndarë nga €100 në mënyrë lineare për punëtorë të administratës e cila shumë është në kundërshtim me rregullat financiare;
7. Janë vërejtur mangësi gjatë aplikimit të procedurave të prokurimit;
8. Çështjet e përmendura më lartë flasin për një performancë jo të kënaqshme të sistemit të kontrollit, të cilat më gjerësisht do të trajtohen në kapitullin VII të këtij raporti.

Rekomandimi ynë kryesor është që, Kryetari i Komunës së Prishtinës duhet të ndërmarrë masa të nevojshme të cilat kryesisht kanë për qëllim përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që siguron besueshmëri dhe integritet të informatave operative dhe financiare dhe ngritjes së performances së kontrollit në tërësi.

## **II. Hyrje**

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është sipas ligjit përgjegjëse për kryerjen e auditimeve vjetore të rregullsisë.

Auditimi i Rregullsisë është definuar si verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e deklaratave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- 1 Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- 2 Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- 3 Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm;
- 4 Për ndershmërinë dhe drejtësinë e vendimeve administrative që merren nga institucioni ose subjekti që i është nënshtruar auditimit; dhe
- 5 Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Është përgjegjësi e menaxhmentit të Komunës së Prishtinës të përgatisë pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP), për “Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme”, në përputhje me Udhëzimin Administrativ 2008/13, dhe ato t’i prezantoj me kohë.

## **III. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara**

Raporti ynë i auditimit të Pasqyrave Financiare të vitit 2007 kishte dhënë 10 rekomandime. Gjatë auditimit tonë të tanishëm ne kemi vërejtur se pesë (5) rekomandime janë implementuar pjesërisht ndërsa të tjerat mbeten ende të pa implementuara.

Fushat më të rëndësishme të cilat duhet ende të adresohen janë:

- Forcimi i kontrollit rreth menaxhimit të të hyrave nga prona publike, raportimin e tyre dhe arkëtimin në llogari të komunës sipas afateve kontraktuese në mënyrë që të parandalohen mundësitë për pagesa jo të rregullta;
- Zhvillimi i procedurave të prokurimit në përputhje me ligjet e aplikueshme;

- Regjistrimi i pasurisë jo financiare ashtu siç kërkohet me UA 2005/11;
- Regjistrimi i plotë dhe saktë i obligimeve financiare dhe raportimi i tyre në Pasqyrat vjetore Financiare;
- Barazimet mujore në mes të të dhënave të drejtorive, regjistrave të bankës dhe librit kryesor (departamentit të Thesarit).

Këto janë disa prej rekomandimeve që nuk po implementohen nga menaxhmenti për vite me radhë dhe që kanë ndikime negative në kredibilitetin e Pasqyrave Financiare.

Për shkak të rëndësisë kyçe të këtyre rekomandimeve, menaxhmentit të komunës i mbetet që të ndërmerr hapa të mëtutjeshëm për implementimin e plotë të të gjitha rekomandimet që kanë mbetur pa u përmbushur nga vitet e kaluara.

#### **IV. Fushëveprimi i auditimit**

Ky auditim ka të bëjë me pasqyrat financiare të Komunës së Prishtinës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2008.

Objektivi primar i këtij auditimi ishte që t'i mundësohet ZAP të shpreh opinionin e saj nëse pasqyrat financiare të Komunës së Prishtinës, japin një pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë dhe nëse regjistrat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me Ligjet dhe rregulloret aplikative.

#### **V. Qasja e auditimit**

Auditimi ynë është planifikuar dhe realizuar gjatë periudhës prej 25/03/2009 deri më 19/06/2009, në bazë të Standardeve të Auditimit të INTOSAI-it.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësive tona, në:

1. Kemi rishikuar pasqyrat financiare të komunës së Prishtinës në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2008;
2. Kemi përcaktuar nëse pasqyrat financiare të komunës së Prishtinës janë përgatitur në pajtim me SNKSP "Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme";
3. Kemi kryer testime substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
4. Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
5. Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit, 5% për paqartësitë dhe 3% për gabimet, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;

6. Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare;
7. Kemi vlerësuar pavarësinë dhe cilësinë e punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm në komunën e Prishtinës , për të përcaktuar nëse mund të mbështetemi në punën e tyre për qëllimet e auditimit tonë.

Të gjeturat dhe konkluzionet tona të auditimit bazohen në dokumentacionin, informatat dhe shpjegimet të cilat na janë dhënë gjatë punës sonë të auditimit.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Prishtinës , standardet ndërkombëtare përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit i cili mund të jepet. Opinioni i auditimit mund të jetë i pakualifikuar, i kualifikuar, i kundërt ose mund të jetë edhe mohim i opinionit (Cf. Aneksi 1 ISSAI 400).

## **VI. Opinioni i auditimit**

Sipas mendimit tonë, Pasqyrat Financiare *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë*, në të gjitha aspektet materiale, pozitive financiare. (ISSAI 400 *Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes* ). Si theksim të çështjes ne dëshirojmë të ju tërheqim vëmendjen në faktin se Komuna e Prishtinës nuk posedon regjistrë final mbi pasuritë e saj (Ndërtesat, pajisjet dhe pasuritë tjera)

## **VII. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit**

### **1. Rezultati Financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar**

Buxheti i tërësishëm i Komunës për vitin 2008 ka qenë €47,319,550. Shpenzimet e përgjithshme në vitin 2008 ishin në shumën prej €34,423,389 apo 73% e buxhetit të aprovuar. Buxheti prej €12,757,925 ose ( 27% ) ishte i pa shpenzuar

Të hyrat e arkëtuara nga burimet vetjake për vitin 2008 ishin €16,198,260, duke mos përfshirë këtu edhe të hyrat nga dënimet në vlerë €931,500 , të hyrat nga gjykata €330,428 dhe të hyrat nga agjensioni i pyjeve €5,231.

### **Konkluzioni**

Sipas vlerësimit tonë Komuna kishte shpenzuar buxhetin për vitin 2008 në kuadër të limiteve të përcaktuara nga Kuvendi me rastin e aprovimit të Buxhetit për vitin 2008. . Megjithatë, buxheti i pashpenzuar prej 27% është një sinjal që KP duhet të përmirësojë planifikimin buxhetor.

## **2. Pasqyrat Financiare**

Pasqyrat Financiare të vitit 2008 nuk janë kompletuara me pasqyrën e pasurive dhe të hyrave.

1. Komuna e Prishtinës nuk mban një Regjistër gjithëpërfshirës dhe të qartë të pasurisë fikse, ku do të paraqitet vlera e përgjithshme e pasurisë së saj;
2. Të hyrat nga shfrytëzimi i pronës publike gjatë vitit 2008 nuk janë inkasuar në llogari të komunës nga dy kompani që ishin kontraktuar.

### **Konkluzioni**

Mos prezantimi i të hyrave të arkëtuara nga shfrytëzimi i pronës publike, regjistrimi jo i plotë i pasurisë jo financiare ka zvogëluar saktësinë dhe besueshmërinë e pasqyrave financiare.

### **Rekomandimi 1**

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- arkëtimin e plotë i të gjitha të hyrave që i takojnë Komunës;
- të bëhet regjistrimi i tërë pasurisë jo financiare me të cilën disponon Komuna. Zbatimi e këtij rekomandimi do të zvogëlonte mundësitë e keq përvetësimit të pasurive publike.

## **3. Realizimi i Buxhetit**

### **3.1 Të Hyrat**

Të hyrat vetjake në Komunën e Prishtinës për vitin 2008 kanë qenë €17,465,420.

Puna jonë audituese ka rezultuar me këto gjetje:

- Të hyrat e inkasuara nuk evidentohen në regjistrat kontabël ,
- Nuk bëhen harmonizime të të hyrave në mes të Drejtorisë së Financave dhe Drejtorive të tjera të cilët mbledhin të hyra, e as ndonjë harmonizim në mes kësaj Drejtorie, Bankave dhe SIMFK;
- Në pasqyrat financiare janë prezantuar si të hyra të tjera shuma prej €15,079,083 për të cilat nuk janë bërë shpallje të mjaftueshme. Me rastin e kthimeve të mjeteve të cilat kanë ndodhur, këto ndryshime zyrtari i të hyrave ka mund t'i vërej vetëm në baze të raporteve të pranuar nga Thesari.



**Tabela 1. Mosbarazimet**

Përshkrimi	Sipas SIMFK (në € )	Sipas Raporteve të drejtorive (në € )	Ndryshimi (në € )
Te hyrat nga licenca	630,405	542,352	88,053
Te hyrat nga leje ndërtimi	7,626,363	7,365,003	261,360
Diferenca në total	<b>8,256,768</b>	<b>7,907,355</b>	<b>349,413</b>

**Konkluzioni**

Mungesa e evidencave kontabël, harmonizimeve dhe shpalosjeve të pamjaftueshme mund të shtoj rrezikun që të hyrat e prezantuara në PF të jenë jo të sakta dhe komplete

**Rekomandimi 2**

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Mbajtjen e regjistrave të plota, të sakta dhe të përditësuara për të gjitha të hyrat vetjake për të siguruar raportim të plotë në pasqyrat financiare;
- Shënimet për të hyrat të harmonizohen me dokumentet burimore, SIMFK, banka dhe sektorin e financave brenda komunës;
- Regjistrimin e të gjitha të hyrave vetjake sipas kodeve të sakta ekonomike të përcaktuar nga Departamenti i Thesarit si dhe bërjen e barazimeve mujore në mes të dhënave të departamenteve, regjistrave të bankës dhe librit kryesor të Departamentit të Thesarit.

**3.1.1 Të hyrat nga tatimi në pronë**

Në vitin 2008 vlera e faturuar ka qenë €5,534,969. Prej tyre janë inkasuar €4,272,122 Në zyrën e ankesave të tatimit në pronë janë pranuar 1017 ankesa. Prej tyre 599 janë Aprovuar, ndërsa 418 janë refuzuar.

**Të gjeturat:**

- Sipas të dhënave të SIMFK-së të hyrat nga tatimi në pronë janë në shumë prej €4,094,295 ndërsa nga raporti i nxjerrë nga departamenti i pronës janë në shumë prej €4,272,122. Ekziston një diferencë e pashpjeguar prej €177,827 Diferencat e konstatuara janë pasoje e mos raportimit dhe mos barazimeve në mes të drejtorisë së tatimit në pronë dhe atij të financave. Gjate kryerjes së auditimit ne nuk kemi qene në gjendje të sqarojmë arsyen e kësaj difference;
- Gjate testimit të 13 të ankesave kemi vërejtur se shqyrtimi dhe marrja e vendimit është bërë me vonesë, e jo në afatin kohor prej 30 dite siç parashihet. Mungesa e të dhënave të sakta për tatimin në pronë ka rezultuar me rritjen e ankesave në vitin 2008.

## **Konkluzioni**

Menaxhmenti e komunës nuk posedon evidenca të sakta mbi të hyrat vetjake. Mungesa e kontrolleve të nevojshme ka ndikuar edhe në rritjen e ankesave lidhur me ngarkesat me tatimin në pronë, çka menaxhmentit të komunës ia bën të vështirë planifikimin e shpenzimit të këtyre të hyrave.

### **Rekomandimi 3**

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Të mbahen evidenca në bazë të dokumenteve burimore dhe të praktikohen harmonizime në mes të drejtorive;
- Të mbaj një bazë të të dhënave lidhur me tatimin mbi pronën, duke përfshirë adresën e poseduesve dhe të shfrytëzuesve të pronës, të dhënat mbi token, ndërtesat, vlerat e pronës. Baza e të dhënave mbi pronën duhet të bazohet në regjistrin e të drejtave mbi pronën dhe kadastrën e tokës.

### **3.1.2 Të hyrat nga shfrytëzimi i pronës publike**

Të hyrat nga prona publike sipas PF kanë qenë €648,945 ndërsa sipas SIMFK të hyrat janë prezantuar në shumë prej €573,799. Shuma e prezantuar nga PF ka përfshirë edhe të hyrat nga shërbimet tjera (konfiskimi i automjeteve).

#### **Të gjeturat kyçe**

- Kontrata e lidhur me datën 02.06.2008 në mes Komunës dhe operatorit ‘‘Park Projekt itg’’ nga Prishtina, në emër të koncesionit të parkingjeve të qytetit në dy zona të qytetit (zona I dhe II gjithsej 357 vend parkime ), parasheh që operatori të paguaj në llogari të Komunës çdo muaj nga €7,800. Nuk kemi gjetur asnjë pagesë në vitin 2008 të kësaj kompanie në dobi të llogarisë komunale. Borxhi i tërësishëm prej vitit 2006 deri në fund të muajit shkurt të vitit 2008 kap shumën prej €95,148, plus pagesat tjera që i takojnë vitit 2008 (7muaj x 7,800= €54,600);
- Gjithashtu kompania ‘‘Beni Dona Plast’’ nga 01.07.2007 deri më 29.02.2008 ka menaxhuar me parkingjet publike pa vazhdim të kontratës dhe borxhi i saj ndaj komunës vlerësohet në €50,137;
- Më datën 23.03.2008 është lidhur kontratë në mes Komunës dhe NPK ‘‘Hortikultura’’, për mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbëruara. Sipas kontratës, NKP ‘‘Hortikultura’’ do të kompensohet nga komuna me 50% nga të hyrat e grumbulluara prej parkut të Gërmis ndërsa, nga kompania ‘‘Hortikultura’’ është kërkuar të raportoj të hyrat e realizuara për çdo dy javë në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjence Civile. Nuk kemi pranuar kurrfarë raporti se kompania në fjalë ka raportuar ashtu siç është kërkuar me kontratë. Përkundër kësaj, NKP ‘‘Hortikultura’’ iu është paguar shuma prej €68,856.

## **Konkluzion**

- Mungesa e pagesave nga kompania për shfrytëzimin e parkingjeve të zonës I dhe II paraqet një menaxhim jo efikas dhe jo efektiv të inkasimit të mjeteve vetjake. Nëse këto mjete nuk derdhen në llogari të Komunës ashtu siç është kërkuar me kontratë, është rrezik që këto mjete të mos paguhen në llogarinë përkatëse të komunës, dhe me mundësi reale që këto mjete të keqpërdoren;
- Përkundër skadimit të afatit kompania "Beni Dona Plast" kishte menaxhuar 345 parkingje të qytetit dhe obligimi i saj ndaj komunës kishte arritur vlerën prej €50,137. Shuma e mbetur e papaguar paraqet edhe një shqetësim të auditimit se realizimi i kontratave nuk është duke u bërë sipas performancës së kënaqshme nga entiteti i audituar;
- Lidhja e kontratës me NKP "Hortikultura" duke mos definuar se sa do t'i kushtojnë komunës shërbimet për mirëmbajtjen e parqeve të komunës së Prishtinës paraqet rrezik që pagesa e paraparë në lartësi prej 50% të hyrave nga parku i Gërmisë të mos jetë e justifikueshme me punët e realizuara.

## **Rekomandimi 4**

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Se kontrolli mbi funksion e faturimit dhe arkëtimit të të hyrave duhet rishikohen. Drejtori për shërbime publike ka për detyrë që të siguroj që të gjitha të hyrat janë faturuar, arkëtuar dhe depozituar në llogari bankare të komunës;
- Të bëhet rishikimi i kontratës me NKP "Hortikultura" dhe të përcaktohen kushtet mbi çmimin e shërbimeve të cilat do t'i kryej kontraktuesi. Vazhdimi i kontratës në këtë mënyrë bënë të pamundur vlerësimin e të hyrave të cilat arkëtohen nga Laura-parku i Gërmisë dhe pagesat ndaj "Hortikulturës";
- Të siguroj që të gjitha të hyrat nga prona e dhëne me qira janë duke u mbledhur sipas afatit kontraktues.

### **3.1.3 Të hyrat nga Licencat për Biznes**

Lejet e punës për zhvillimin e veprimtarisë biznesore Komuna i lëshon në bazë të Rregullores për Leje pune të Shoqërive tregtare nr. 330-657.

Neni 7.1 i Rregullores për Leje pune të Shoqërive Tregtare parasheh që Leja e punës të jepet në afat të pacaktuar, përveç nëse me Ligj të veçantë është e paraparë ndryshe. Ne kemi vërejtur raste kur lejet lëshohen për periudha të caktuara kohore dhe më pas vazhdojnë.

## **Të gjeturat**

- Sektori i zhvillimit të bizneseve ka një softuer aplikativ për futjen e të dhënave, mirëpo ky softuer nuk është i dizajnuar në atë mënyrë që të mund të ofroj raporte në baza ditore, javore, apo sipas specifikave tjera të nevojshme. Edhe

stafi i këtij sektori nuk është trajnuar në mase të duhur për përdorimin e këtij sistemi në mënyrë efikase;

- Nuk janë përcaktuar kriteret për vazhdim të lejes së punës, cilat dokumente do të duhej të i bashkëngjiten dosjes së aplikimit në rastet e vazhimit.

#### **Konkluzionet:**

- Dobësitë e sistemit aplikativ dhe mungesa e trajnimeve të stafit janë faktor që ndikojnë në evidentime dhe raportime të dobëta;
- Mos përcaktimi i qartë i kriterëve të zhvillimit të procedurave të vazhimit të lejeve të biznesit mund të krijoj mundësi të favorizimeve mbi baza preferenciale apo edhe diskriminime mbi baza subjektive

#### **Rekomandimi 5**

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Evitim të defekteve të softuerit dhe të mbështet stafin me trajnime të nevojshme për përdorimin adekuat të sistemit;
- Të përcaktohen qartë kriteret e Rregullores në bazë të të cilave do të përcaktohet se në cilat raste do tu jepet leja e përhershme e punës dhe në cilat do të rishqyrtohet vazhdimi.

#### **3.1.4 Të hyrat nga Lejet e Ndërtimit**

Departamenti i Urbanizmit ofron evidenca të ndryshme për të hyrat që janë inkasuar në 2008 në krahasim me SIMFK Sipas SIMFK të hyrat nga lejet e ndërtimit kanë qenë €7,626,363, kurse sipas Raportit vjetor të departamentit vlera e tyre është €7,615,488

#### **Të gjeturat**

- Raporti analitik i departamentit prezanton të hyra nga leje ndërtimi në vlerë prej €7,365,003, ndërsa në raportin vjetor të departamentit janë prezantuar €7,615,488. Diferenca prej €250,485 ka rezultuar nga pagesat e bëra drejtpërdrejt në llogari të Komunës pa aktvendime përkatëse;
- Në dy raste ka pasur vonesa në inkasimin e të hyrave. Shuma e cila do duhej të inkasohet nga këto 2 aktvendime ka qenë €1,057,315 kurse janë inkasuar €728,554 , shuma prej €328,761 nuk është inkasuar në kohën e paraparë me aktvendim. Disa nga vonesat në pagesa datojnë nga tetori i vitit 2007.

#### **Konkluzionet:**

- Departamenti i urbanizmit nuk ka raportuar të hyrat në bazë të të dhënave sipas aktvendimeve të lëshuara;
- Mungon kontrolli adekuat i departamentit të Urbanizmit për përcjelljen e pagesave, në mënyrë që të hyrat të inkasohen me kohë.

## **Rekomandimi 6**

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Një analizë të thellë përse kompanitë paguajnë para kohe, dhe të ndërmerr masa adekuate për eliminimin e kësaj dukurie. Deri në Tetor të vitit 2009, komuna duhet të dalë me masa konkrete lidhur me këtë dukuri;
- Vendosjen e një kontrolli adekuat në mënyrë që të hyrat të inkasohen sipas afateve të parapara me aktvendime.

## **3.2 Paga dhe Mëditje**

Komuna e Prishtinës në vitin 2008 ka pasur gjithsej 4865 punëtorë. Shpenzimet për paga dhe mëditje kapin shumën prej €13,058,540, krahasuar me vitin 2007 ka pasur një rritje prej 9.3% kurse përqindja më e madhe ka rezultuar me pagesat për stimulime 158%.

### **E gjetura**

Në Komunë janë të punësuar rreth 36 punëtor në emër të pilot projektit për financa dhe tatim në pronë që nga viti 2001 dhe kanë vazhduar të punojnë edhe më tutje. Zyra e personelit nuk disponon me kontrata për 36 punëtorë të pilot projektit si dhe mënyrën e rekrutimit dhe sistematizimit të tyre.

### **Konkluzioni**

Mënyra e rekrutimit të personelit pa u përfillur rregullat mbi shërbyesit civil është në kundërshtim me UA Nr.MSHP/DASHC 2003/01 “Procedurat e rekrutimit”

## **Rekomandimi 7**

Rekomandojmë Kryetarin e komunës që të siguroj:

Respektimin e dispozitave ligjore lidhur me rekrutimin e stafit në punë dhe për çdo të punësuar të lidhet kontrata valide e nënshkruar nga dy palët.

### **3.2.1 Shpenzimet për Punët jashtë orarit**

Gjate vitit 2008 shpenzimet në emër të punëve jashtë orarit (stimulimeve) janë në vlerë prej €337,163 apo për 158 % më të larta se në vitin 2007. Në kuadër të këtyre punëve jashtë orarit janë të përfshirë edhe 685 punëtorë të administratës. Nga ekzaminimi i listave përkatëse kemi vërejtur se për secilin nga përfituesit janë llogaritur për gjashtë (6) mujorin e fund vitit 2008, 240 orë jashtë orarit të punës dhe llogaritja është bërë në mënyrë proporcionale. Sipas Urdhërësës Administrative Nr.2003/2, për Zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr.2001/36 Mbi Shërbimin Civil të Kosovës , udhëheqësi mund të kërkoj nga punonjësit të punoj jashtë orarit, por kjo nuk mund të kaloj 20 orë në javë apo 40 orë në muaj.

Me rastin e ekzaminimit të listave të stimulimeve të 5 drejtorive nuk kemi gjetur dëshmi të

mjaftueshme sipas secilës do të justifikohet pagesa për punën jashtë orarit. Po ashtu nuk ka ndonjë dëshmi se këta përfitues janë angazhuar nga eproret e tyre.

## **Konkluzion**

Pagesat e stimulimeve për punë jashtë orarit pa vendime të menaxhmentit janë të pa bazuara. Kjo formë e angazhimit nuk është në përputhje me nenin. 19 të Urdhëresës Administrative Nr. 2003/2

## **Rekomandimi 8**

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

Vendimet e menaxhmentit se punët jashtë orarit janë të nevojshme/arsyeshme dhe në pajtim të plotë me aktet ligjore në fuqi. Gjithashtu të siguroj se shpenzimi i buxhetit të bëhet në përputhje të plotë me LMFP .

## **3.3 Mallrat dhe Shërbimet**

### **3.3.1 Shpenzimet e karburanteve**

Shpenzimet e karburanteve gjatë vitit 2008 janë €1,094,659. Prej tyre €157,438 janë shpenzime të karburanteve për automjete, ndërsa pjesa tjetër për ngrohje të shkollave. Krahasuar me vitin 2007 shpenzimet e karburanteve në vitin 2008 kanë shënuar një rritje prej 38%. Objekt i testimit kanë qenë shpenzimet e karburanteve të automjeteve të administratës, në vlerë €57,462

### **Të Gjeturat:**

- Nuk na janë ofruar dëshmi me dokumente se sa ka qenë gjendja fillestare e kilometrave për çdo automjet në fillim të vitit 2008. Po ashtu nuk na janë ofruar kuponët e furnizimit me derivate për çdo muaj me (përfashtim të muajit dhjetor), dhe urdhëresat për shfrytëzimin e veturave;
- Komuna nuk kanë një normativ të shpenzimeve mesatare të secilit tip të veturave ose automjeteve tjera. Mesatarja e shpenzimeve për të njëjtin tip të automjeteve me të njëjtat karakteristika ndryshon. P.sh. tek Renault Megane, mesatarja e shpenzimeve vjetore sillet nga 9 litra deri në 14 litra për të njëjtin tip. Pastaj, tek veturat e Tipit LLada-Niva mesatarja e shpenzimeve për 100 Km ka arritur deri 19 litra. Komuna nuk ka bërë ndonjë Kontroll dhe analizë të brendshme që të mund të identifikoj arsyet e ndryshimeve mjaft të mëdha të shpenzimeve mesatare për muaj, për të njëjtin tip të automjeteve;
- Shpenzimet e derivateve sipas Raporteve mujore nuk përputhen me shpenzimet sipas raportit vjetor;
- Kërkesa për shfrytëzim të automjeteve ka raste që bëhet një herë në muaj e jo çdo dite kur shfrytëzohet automjeti. Drejtoritë zbatojnë rregulla të ndryshme tek përdorimi i automjeteve.

## **Konkluzionet:**

- Evidencat që mbahen janë të pamjaftueshme që menaxhmenti të ketë kontroll adekuat mbi shpenzimet e karburanteve;
- Nëse nuk ekziston një normativ i shpenzimeve, nuk mund të bëhen krahasimet në mes normativit të lejuar dhe shpenzimeve faktike të karburanteve. Në kushte të tilla, kontrollet janë të pa mundshme;
- Ndryshimet e mesatares së shpenzimeve për automjetet me të njëjtat karakteristika janë rezultat i kontrolleve të pa përshtatshme të vendosura nga Komuna;
- Mos përputhja e raporteve mujore me ato vjetore e ulë besueshmërinë në saktësinë dhe plotësinë e këtyre raporteve;
- Mos unifikimi i plotësimit të urdhëresave nga të gjithë, para çdo udhëtimi mund të krijojë mundësinë e keqpërdorimit të automjetit për udhëtime dhe shfrytëzim për qëllime tjera.

## **Rekomandimi 9**

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Që për çdo automjet të përcaktohet një normativ i shpenzimit të derivateve dhe të mbahen evidenca të sakta për kilometrazhin fillestar dhe përfundimtar të çdo automjeti në çdo periudhë kohore;
- Të analizohet gjendja teknike e automjeteve, dhe për automjetet e vjetruara të cilat krijojnë shpenzime enorme, të rishikohet arsyeshmëria e përdorimit të tyre;
- Raportet mujore duhet të përputhen me raportin vjetor mbi shpenzimet e karburanteve. Kjo i mundëson menaxhmentit marrjen e vendimeve adekuate;
- Menaxhmenti duhet të vendos standarde dhe rregulla unike për të gjitha drejtoritë në plotësimin dhe aprovimin e udhëtimeve;
- Të aplikohet sistemi i urdhëresave të udhëtimit. Urdhëresat të aprovohen (nënshkruhen) nga menaxhmenti.

### **3.3.2 Furnizim me naftë për shkolla**

#### **Të gjeturat**

- Në dosjen e operatorit ekonomik që e ka fituar tenderin mungon garancioni i sigurimit të ekzekutimit të punëve në vlerën prej €92,866;
- Nuk është e qartë se nga është marre çmimi i berëzës dhe nuk dihet se cili autoritet e kalkulon këtë çmim të berëzës. Zyrtarët përgjegjës nuk ishin në gjendje të japin shpjegime;
- Premiumi i kompanisë fituese është shumë i ulët në krahasim me ofertuesit tjerë.

## **Konkluzionet**

- Mungesa e sigurimit të ekzekutimit nga ana e OE fitues është në kundërshtim me nenin 60.1 dhe nenin 60.2 të LPP Nr. 02/L-99, dhe nuk siguron që OE do të jetë i përgjegjshëm në realizimin e kontratës sipas kushteve të parapara;
- Mosdhënia e shpjegimeve për burimin e çmimeve të berëzës ngrit dyshime në saktësinë dhe korrektësinë e këtyre të dhënave;
- Nuk ka ndonjë dëshmi se është diskutuar me OE për çmimin që është ofruar edhe pse ka qenë tepër i ulët në krahasim me OE tjerë.

## **Rekomandimi 10**

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- forimin e kontrolleve mbi proceset e prokurimit dhe të trajtoj barabarësish të gjithë ofertuesit në konkurrencë, duke respektuar kërkesat ligjore mbi formimin e dosjeve;
- Informata relevante për saktësinë dhe burimin e këtyre raporteve për çmimet e berëzës, duke pasur parasysh se OE në bazë të tyre edhe furnizon me naftë AK, dhe të shtojë kontrollin në sasinë që pranohet;
- Se është diskutuar çmimi me OE me qëllim të eliminimit të mundësisë së ndryshimit të kushteve të kontratës nga ana e OE për shkak të çmimit.

### **3.3.3 Arkivimi i dokumentacionit të Komunës së Prishtinës**

#### **E gjetura**

Ky projekt është realizuar përmes procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës. Prokurimi është aprovuar në APP. Mirëpo pas aprovimit të procedurës së negociuar, komuna nuk ka lënë kurrfarë dëshmish se ka zbatuar procedurat e kërkuar me Ligjin e Prokurimit Publik - neni 34.9 për të cilat edhe APP bën përgjegjës.

#### **Konkluzion**

Komuna e Prishtinës nuk ka zhvilluar procedura të negocimit me OE në mënyrë që të siguroj se kontrata e shpërblyer dhe është në përputhje me kushtet më të mira, çmimin më të volitshëm, përkatësisht në përputhje me çmimet e tregut.

## **Rekomandimi 11**

Rekomandojmë Kryetarin e komunës që të siguroj:

- Zbatimin e të gjitha procedurave të negocimit për të fituar çmim jo më të lartë se çmimi i tregut dhe kushte të tjera të përshtatshme të kontratës që do të jenë të favorshme për Komunën.



### **3.3.4 Riparimi i Auto veturave kontrata sipas çmimit për njësi**

#### **Të gjeturat**

- Dosja e Tenderit për të aplikuar u është dhënë tri (3) kompanive. Sipas një regjistri vërehet se kjo dosje u është dhënë me vonesë. Nga shënimet vërehet se u është dhënë afat vetëm 4 ditë. (Data e ftesës në Dosje të tenderit është 17.11.2008 ndërsa në regjistrin e evidencës për dhënie të dosjeve të të ftuarve figuron se operatorëve u është dhënë kjo ftesë me datë; 24.11.2008). Gjithashtu kemi hasur mos harmonizim të pohimeve midis Procesverbalit të hapjes dhe Dosjes së tenderit. (Sipas Dosjes së tenderit data e fillimit është 17.11.2008, data e hapjes së ofertave është 28.11.2008);
- Në dosjen e prokurimit nuk kemi gjetur ndonjë procesverbal apo raport që përshkruan procesin e vlerësimit të ofertave, arsyetimet, kriteret dhe elementet e tjera që kanë ndikuar në përzgjedhjen e OE më të përgjegjshëm. KRPP- ka të nxjerrur formular standard të raporteve të cilët janë të obligueshëm të përdoren me rastin e vlerësimit të ofertave;
- Dy nga tri ofertat kanë qenë të pa përgjegjshme për nga aspekti i kërkesave administrative, sepse nuk i kanë ofruar dokumentet e kërkuara (VI-PO Company dhe EL- Partners i mungon Çertifikata e kryerjes se obligimeve tatimore, Dëshmia e pagesës së energjisë elektrike).

#### **Konkluzionet**

- Pohimet e pa qarta dhe të pa harmonizuara në dokumentet e komunës në lidhje me afatet kohore të përcaktuara me LPP-së mund të jenë indikacione se përfitimi i kontratës mund të i jetë parapërgatitur OE te paracaktuar;
- Mungesa e dëshmimeve të procesit të vlerësimit të prokurimit është në mospërputhje me parimin e transparencës dhe mund të përcillet me mos besueshmëri të vlerësimit të drejtë. Zbatimi i këtij parimi është i kërkuar edhe me nenin 9 të LPP-së.

#### **Rekomandimi 12**

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Transparencë të mjaftueshme të zhvillimit të procesit të vlerësimit të ofertave.

### **3.4 Prokurimi**

Në vitin 2008 janë lidhur 208 kontrata kurse 98 aktivitete tjera të prokurimit kanë përfunduar me anulimin e tenderëve. Në vitin 2008 vlera e parashikuar e prokurimeve ishte 21.8 milion euro ndërsa vlera e kontratave ishte mbi € 19.1 milion euro. Për testim dhe analizë janë marrë 20 mostra që përfshijnë vlerën mbi 33% të totalit.

## **Të gjeturat e përbashkëta janë:**

- Shtatë (7) projekte nuk ka qenë të planifikuar me Plan të Prokurimit;
- Në tetë (8) mostra kemi vërejtur se zotimi i mjeteve është bërë pas datës së nënshkrimit të kontratës. Gjithashtu një pjesë e Zotimit dhe Pagesave janë bërë nga buxheti i Administratës, kurse pjesa tjetër nga buxheti i Arsimit, me arsyetim të mungesës së mjeteve, për projekt të njëjtte;
- Tek të gjitha mostrat, raportet e Pranimit (formulari i Thesarit) për realizimin e një pagese nuk japin detale se çka është pranuar por janë shume të mangëta me informata dhe vetëm ceket se duhet të paguhet kjo faturë në këtë vlerë;
- Tek dy (2) mostra sigurimi i ekzekutimit të punëve është bërë pas nënshkrimit të kontratës dhe pas përfundimit të punës atëherë kur edhe janë kryer të gjitha pagesat ndaj OE për punën e kryer. Neni 60.1 dhe neni 60.2 i LPP kërkon si parakusht për nënshkrimin e kontratës të bëhet sigurimi i ekzekutimit të punës. Kurse me kontratë në nenin 12 është paraparë që garancioni të sigurohet në fund të punimeve;
- Në një rast është lidhur kontrate me operatorin në shumë prej €766,386, dhe pas 24 ditëve nga nënshkrimi i kontratës me OE është bërë ndryshimi i kontratës në shumë prej €463334. Ky ndryshim i vlerës së kontratës është justifikuar me mungesë të disponueshmërisë së mjeteve.

## **Konkluzionet**

- Janë vërejtur dobësi në Planifikimin e aktiviteteve të prokurimit. Kjo ka ndikuar në ndërrimin e destinimit të shpenzimit të mjeteve buxhetore;
- Pagesat nga kodet e ndryshme të programeve si rezultat i mungesës së buxhetit për realizimin e këtij projekti tregon për mos planifikim të duhur të shpenzimeve të buxhetit, çka ndikon në çorientimin e raporteve financiare mbi shpenzimet;
- Raportet e Pranimit që nuk shpalosin në forme të qartë se cila është sasia e mallit dhe shërbimeve të pranuar (në këtë rast të naftës) dhe si të tilla sjellin në pikëpyetje arsyeshmërinë e pagesave;
- Sigurimi i ekzekutimit pas përfundimit të punimeve nuk siguron që OE do të jetë i përgjegjshëm në realizimin e kontratës sipas kushteve të parapara;
- Mos parashikimi me kohë i nevojave mbi disponueshmërinë e mjeteve ka si pasojë edhe mos realizimin e projekteve kapitale.

## **Rekomandimi 13**

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Planifikimi i buxhetit të bëhet nga kodet adekuate të projekteve dhe programeve;
- Raportet e Pranimit të mallrave apo shërbimeve duhet të jenë të plota dhe të sakta dhe të jenë dëshmi i sigurt se pagesa duhet kryer;
- AK duhet paraprakisht të siguroj fondet e mjaftueshme që të mund të inicioj zhvillimin e procedurave dhe kontraktimit të çdo shërbimi ose pune;
- Kushtet e përcaktuara në kontrate duhet të jenë në pajtim të plotë me kërkesat e LPP-së që sigurimi i ekzekutimit të bëhet para nënshkrimit të kontratës.

## 3.5 Investimet Kapitale

Gjatë vitit 2008 shpenzimet aktuale ishin në vlerë prej €15,307,771 apo për 63% më të larta se në vitin 2007.

### 3.5.1 Ndërtimi i Objektivit të Komunës

OE fitues nuk ka qenë i përgjegjshëm, ngase nuk i ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara. Operatorit fitues i ka munguar raporti i auditimit dhe ka ofruar vetëm pasqyrat financiare të nënshkruara nga një auditor..

Ky kriter ka qenë një ndër arsyet e eliminimit të operatorit ekonomik më të lirë prej €351,201. Punimet fillestare në objekt gjatë 13 ditëve të para janë zhvilluar pa praninë e organit mbikëqyrës.

### Konkluzion

- Është përzgjedhur fitues OE i cili nuk ka qenë tërësisht i përgjegjshëm në përputhje me kërkesat mbi gjendjen ekonomiko financiare, të përcaktuara në bazë të nenit 63 të LPP-së;
- Mungesa e Mbikëqyrësit të punimeve në fazën fillestare të projektit mund të ketë ndikuar kualitetin e kryerjes së punimeve, rrjedhimisht edhe në kryerjen e pagesave për të cilat menaxhmenti i komunës nuk ka pasur siguri të mjaftueshme.

### Rekomandimi 14

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Të forcoj kontrollet në zbatueshmërinë e drejtë të kërkesave të LPP-së, në veçanti në përdorimin e drejtë të kriterëve të parashtruara për përzgjedhjen e punëkryesve;
- Të siguroj Mbikëqyrje të vazhdueshme në realizimin e projekteve të ndërtimit.

### 3.5.2 Rindërtimi i rrugës së Shkupit –Pjesa I :

Pagesa është bërë nga Kodet e ndryshme të projekteve dhe kodet e ndryshme të programeve e që nënkupton se kemi të bëjmë me një planifikimi jo të mirë të shpenzimeve për këtë projekt. Realizimi i projektit ka filluar para se fondet të jenë siguruar.

### Konkluzionet

Komuna ka krijuar obligime para se ti siguroj fondet për realizimin e këtij projekti. Kjo mund të bart rrezikun e krijimit të kontesteve gjyqësore.

Pagesat nga kodet e programeve jo adekuate si rezultat i mungesës së buxhetit për realizimin e projektit ndikojnë në raportimet financiare të pa qarta të shpenzimeve.

### **Rekomandimi 15**

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

Të forcoj kontrollet e duhura në Planifikimin e prokurimeve dhe shpenzimi i fondeve të bëhet në bazë të programeve përkatëse.

#### **3.5.3 Ndërtimi i rrugës Slivovë - Viti e Marevcit**

Ky projekt ka qenë bashkëfinancim; nga buxheti i komunës €800,000 dhe €505,000 nga Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit (MTPT). Marrëveshja për bashkëfinancim është bërë me datën 23.09.2008. Sipas marrëveshjes ne mes tyre janë parapare edhe përgjegjësit për përcjelljen e projektit. Kuvendi komunal dhe MTPT sipas marrëveshjes duhej të emëronin nga një menaxher për realizimin e projektit.

#### **Të gjeturat**

- Për situacionin e dytë është paguar shuma prej €505,000 nga MTPT në bazë të faturimit, ndonëse punimet për këtë vlerë të paguar nuk ishin kryer;
- Dosja standarde e tenderit për kompaninë fituese "Alko Impex" nga Prishtina nuk është gjetur complete.

#### **Konkluzionet**

- Sipas përlogaritjes së situacionit të dytë, shuma e paguar prej €505,000 përfshin parapagimin prej €274,143. Raporti i pranimit të punëve është bërë nga menaxheri i komunës derisa marrëveshja obligon që Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit të caktoj një menaxher për përcjelljen e projektit. Funkcioni i mbikëqyrjes nuk ka funksionuar në mënyrën e duhur;
- Mungesa e dokumentacionit të dosjeve nga Zyra e prokurimit shkakton pa qartësi mbi rregullsinë dhe zhvillimin e procedurave.

### **Rekomandimi 16**

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Që pagesat ndaj punekryesit të jenë në harmoni me punët e kryera si dhe të siguroj se përcjellja e punimeve, dhe pranimi i punëve bëhet në harmoni me kushtet e kontratës;
- Që për çdo tender të kryer, Zyrtari i Prokurimit duhet të mbajë dokumentacionin të kompletuar për të gjitha fazat e realizimit të projektit.

#### **3.5.4 Ndërtimi i rrugës Ballaban-Keqekollë**

Fillimi i punimeve sipas ditarit të punës është bërë me datën 18 qershor 2007 dhe përfundimi i punimeve është planifikuar me 18 shtator 2007, siç ishte parashikuar edhe me kontratë. Megjithatë, punimet janë kryer me datën 03 shtator 2008 ndërsa pranimi teknik

është bërë me datën 08 shtator 2008.

## **E gjetura**

Janë paguar 4 situacione në vlerë prej €400,516 kurse punët janë pranuar në vlerë prej €435,076. Sipas kushteve të veçanta të kontratës për çdo ditë vonesë punë kryesit duhej t'i llogaritej ndalesa prej 0.05%. Komuna ka zbatuar këtë ndalesë vetëm për 5 muajt e konsideruar si vonesë.

## **Konkluzion**

Përlllogaritja e vonesave ndaj punëkryesit vetëm për 163 dite kalendarike nuk është në përputhje të plotë me kushtet e veçanta të kontratës. Përfundimi i projektit me gati një vit vonesë është e papranueshme dhe autoritetin kontraktues e obligon të zbatoj ndëshkimet sipas kontratës.

## **Rekomandimi 17**

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

Të respektohen të gjitha kushtet e kontratës dhe ndalesat e parapara të aplikohen për çdo ditë vonesë. Menaxhmenti i komunës duhet të forcoj kontrollet lidhur me realizimin me kohë të projekteve si dhe të ndërmerr masa për eliminimin e shkaqeve që ndikojnë në këto vonesa.

### **3.5.5 Ndërtimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare në Lagjen Vreshtat dhe në Velani**

## **E gjetura**

Janë bërë pagesat për kryerjen e punimeve, ndërsa nuk është përpiluar Raport Situacioni për punët e kryera për tu siguruar se puna e kryer është në përputhje me vlerën e parave të paguara. Pagesa është bërë vetëm përmes faturës.

## **Konkluzion**

Pagesat e kryera pa krijimin e raporteve të qarta debitorë/kreditore të cilat përshkruajnë në detaje të gjitha pozicionet dhe sasisë e punëve të kryera mund të kenë për pasojë shpenzimin e parave për punë që mund të mos jenë kryer.

## **Rekomandimi 18**

Rekomandojmë Kryetarin e komunës që të siguroj:

- Para kryerjes së pagesës, duhet të mblidhen të gjitha dëshmitë dhe duhet të ketë bazë të mjaftueshme ligjore shumat që duhet të paguhet në kundërvlerë të punës së kryer.

### **3.5.6 Punët shtesë në projektin Shkolla fillore ne Lagjen Vreshtat**

Një projekt për ndërtimin e Shkollës fillore “Lagja e Vreshtave” është ekzekutuar gjatë vitit 2007. Kontrata bazë e këtij projekti ka qenë €1,767,367. Realizimi i këtij projekti është vazhduar tri herë me punët shtesë dhe rrjedhimisht edhe me pagesat përkatëse.

Pagesa e parë prej €290,750. ka të bëjë me punët shtesë për shkak të mos kryerjes së shpimeve gjeomekanike. Komuna është dashur të ndërroj lokacionin për ndërtim të objektit. Edhe pse zhvendosja e lokacionit është bërë, përsëri gjatë vitit 2008 kanë ndodhur ndryshime në paramasën e punëve, të cilat po ashtu janë përcjellë me pagesa tjera shtesë. Ndryshimet në paramasë kanë të bëjnë me punët e kulmit të shkollës, të cilat fillimisht nuk ishin parashikuar. Dy herë aneks kontrata janë lidhur në bazë të procedurës së negociuar; njëra në vlerë prej €27,650, dhe tjetra €14,768.

Auditimi ynë ka identifikuar se:

- Janë aprovuar, zhvilluar dhe me pas janë paguar punë shtesë në kundërshtim me nenin 34.2 të LPP-së pika IV. Këto punë vërehet se kanë qenë pasojë e lëshimeve dhe neglizhencës së autoritetit kontraktues e jo punë të pa parashikuara.
- Nuk janë gjetur dëshmi mbi negociatat e zhvilluara në mes komunës dhe operatorit ekonomik, të kërkuara me nenin 34.9;
- Mungon Situacioni i qartë i raportimit nga ana e mbikëqyrësit të punimeve me informacione të plota të punimeve të kryera, përmes së cilave do të dëshmoreshin pagesat e bëra.

### **Konkluzion**

- Aktivitet shtesë të zhvilluara si pasojë e lëshimeve dhe neglizhencës së AK mund të shkaktojnë dëmtim të parësë publike dhe janë në mos përputhje me nenin 34.2 të LPP-së, pika IV;
- Pagesat e kryera pa krijimin e raporteve të qarta debitorë/kreditore të cilat përshkruajnë në detaje të gjitha pozicionet dhe sasitë e punëve të kryera mund të kenë për pasojë shpenzimin e parave për punë që mund të mos jenë kryer;
- Komuna e Prishtinës nuk ka zhvilluar procedura të negociimit me OE në mënyrë që të siguroj se kontrata e shpërblyer është në përputhje me kushtet me të mira, çmimin me të volitshëm dhe në përputhje me çmimet e tregut.

### **Rekomandimi 19**

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj se:

- Të gjitha projektet e ndërmarra janë parashikuar mirë në kuptimin sasior dhe cilësor dhe të evitohet të gjitha ato aktivitete të cilat kanë mund të rrjedhin nga lëshimet dhe neglizhencat që në raste të ndryshme mund të jenë të qëllimshme;
- Ka zbatuar të gjitha procedurat e negociimit për të siguruar çmim jo më të lartë se çmimi i tregut dhe kushte të tjera të përshtatshme të kontratës që do të jenë të favorshme për komunën;

- Në rastet kur do të bëhen pagesa komuna duhet të sigurohet se ekziston baza e duhur debi/kredi, respektivisht pagesat kanë kundërvlerën në punën e kryer.

### **3.6 Subvencionet dhe Transferet**

Komuna e Prishtinës ka ofruar përkrahje financiare disa projekteve, duke përfshirë në lëmin e sportit, kulturës, teatrit "Dodona" sektorit të bujqësisë, projekte të individëve, si dhe ndihmë për punëtorët e administratës së komunës.

Me qëllim të vërtetimit të rregullsisë së shfrytëzimit të subvencioneve është bërë sipas rregullave financiare, kemi testuar tri (3) lëndë .

#### **Të gjeturat**

- Nuk kemi gjetur se si janë përcaktuar kriteret për 200 familje përfitues të subvencioneve në vlerë €33,600 me farë gruri dhe plehra minerale;
- Në një rast kemi vërejtur se është ndërruar përfituesi i subvencionit për të cilin ndryshim nuk është konstatuar arsyeja;
- Dy familje të cilat kanë përfituar ndihma me farë gruri dhe plehra minerale për mbjellje prej 1 ha i mungon emri dhe mbiemri i tyre. Komisioni për pranim ka konstatuar se këto dy familje kanë pranuar 300 kg. farë gruri dhe 300 kg. plehra mineral pa përmendur se për kë bëhet fjalë. Komuna duhet të disponoj me emrat për të gjithë përfituesit e ndihmës sociale;
- Me datën 21.05. 2008, në mbledhjen e kuvendit komunal është marre vendimi për lejimin e mjeteve në shume prej € 80,000 si ndihme për punëtorët e administratës komunale.

#### **Konkluzionet**

- Dhënia e subvencioneve nga entiteti duke mos përcaktuar fillimisht kriteret mbi bazën e të cilit do të bëhet selektimi i përfituesve, paraqet një rrezik që fondet e dedikuara si subvencione të mos u adresohen personave në nevojë;
- Në mungesë të emrave të përfituesve të kësaj ndihme nga ana e komunës, paraqitet rreziku që përfitues të jenë persona jashtë listës së aprovuar nga komisioni;
- Vendimi i marre nga kuvendi komunal është në kundërshtim me UA 2005/08 sepse transferet duhet të jepen për ata individ apo institucione që nuk financohen nga BKK-së.

#### **Rekomandimi 20**

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Planifikimi i subvencioneve të kryhet sipas prioriteteve të caktuara. Me rastin e shpërndarjes së këtyre ndihmave, të përpilohen raporte të qarta mbi shfrytëzuesit;
- Që me rastin e marrjes së vendimeve për transfere të mjeteve të merret parasysh baza juridike ligjore.

### **3.7 Menaxhimi i pasurive**

#### **Të gjeturat:**

Komuna e Prishtinës gjatë vitit 2008 nuk kishte mbajtur një regjistër gjithëpërfshirës dhe të qartë të pasurisë fikse. Përveç inventarizimit në fund të vitit, nuk kishte formuar komision për vlerësim të pasurive fikse siç janë toka, ndërtesat dhe rrugët.

#### **Konkluzioni**

Komuna nuk ka nën menaxhim të plotë pasuritë e saj, siç përcaktohet me rregullativën ligjore. Nëse menaxhmenti nuk ka informacione të plota mbi gjendjen e tyre në posedim pasuritë e saj nuk do të mund t'i mbroj nga dëmtimi, humbja apo keqpërdorimi i mundshëm.

#### **Rekomandimi 21**

##### **Rekomandojmë Kryetarin e komunës që të siguroj:**

- Formimin e një komisioni i cili do të bënte regjistrimin dhe vlerësimin e pasurisë fikse të komunës çdo vit;
- Të krijoj një regjistër gjithë përfshirës të pasurive fikse, duke u bazuar në informacionet e ofruara nga baza e të dhënave të lokacionit. Përveç të tjerash, ky regjistër duhet të përmbaj vlerën e pasurive fikse dhe të dhënat e personit i cili është i ngarkuar me të.

### **3.8 Menaxhimi i Automjeteve**

Nuk mbahen evidenca të veçanta për udhëtimet zyrtare. Ato bëhen për një ditë ose për një muaj dhe nuk ka një rregullore unike që do të ishte e vlefshme për tërë stafin komunës. Drejtoritë komunale aplikojnë metoda të ndryshme të evidencave.

#### **Konkluzioni**

Komuna nuk ka kontrole të përshtatshme mbi menaxhimin e automjeteve. Mungesa e një politike (rregullore) efektive të menaxhimit të automjeteve krijon mundësinë që përdorimi i automjeteve të mos bëhet gjithëherë për nevoja zyrtare.

#### **Rekomandimi 22**

##### **Rekomandojmë Kryetarin e komunës që të siguroj:**

- Të monitoroj shfrytëzimin e automjeteve në mënyrë të rregullt në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e UA nr. 03/2008;
- Të nxjerrë rregullore të brendshme mbi procedurat e përdorimit të automjeteve dhe shpenzimet e karburanteve.



#### **4. Sistemet e Kontrollit të brendshëm**

Kapitujt e përshkruar më lart flasin për dobësi evidente të kontrollit të brendshëm të komunës, dhe rishikimi funksional i sistemit ka nevojë të bëhet.

Për pasojë, kontrollet e brendshme të vendosura nga menaxhmenti i komunës për parandalimin, zbulimin dhe korigjimin e gabimeve, parregullsive dhe mashtrimeve potenciale nuk kanë funksionuar mjaftueshëm dhe kjo ka pasur refleksione të caktuara edhe në përmbushjen e objektivave të përcaktuara.

#### **Rekomandimi 23**

Rekomandojmë Kryetarin e komunës që të siguroj:

Për të rritur sigurinë e funksionimit të kontrolleve të përgjithshme të merr masa të menjëhershme për lansimin e një programi rigjallërues nën udhëheqjen e tij.

#### **5. Auditimi i Brendshëm**

Auditimi i brendshëm është segment i rëndësishëm i menaxhimit sipas së cilit organizata e ruan integritetin, efikasitetin e efektivitetin e sistemit financiar dhe të sistemeve të tjera të menaxhmentit të kontrolleve. Roli kryesor i Njësisë së Auditimit të brendshëm është ofrimi i sigurisë për menaxhmentin që sistemi i kontrollit të brendshëm funksionon siç është synuar.

NjAB gjatë vitit 2008 kishte një menaxher dhe dy zyrtarë. Gjatë auditimit kemi shqyrtuar raportet dhe të gjeturat e tyre të cilat mbulonin periudhën e vitit 2008.

NjAB-i kishte ndërmarrë aktivitete për të audituar procedurat e prokurimit si një ndër fushat e vlerësuara me rrezik të lartë në vitin 2008. Në raportin e lëshuar për këtë auditim janë vërejtur shumë nga parregullsitë dhe janë dhënë rekomandime përkatëse. Megjithatë, komuna ende nuk ka bërë hapa të rëndësishëm për ti zbatuar rekomandimet.

Komuna ka themeluar edhe Komitetin e auditimit. Megjithatë Komuna nuk ka ndërmarrë masa për implementimin e rekomandimeve. Ky komitet, sipas stafit menaxhues të NjAB-së ka bërë aprovimin e Planit të auditimit 2008, Planin strategjik 2009/2011, Planin vjetor 2009 dhe vazhdimisht është marrë me diskutimin dhe trajtimin e Raporteve të auditimit të brendshëm.

#### **Rekomandimi 24**

**Rekomandojmë Kryetarin e komunës që të siguroj :**

Marrjen e masave të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të nxjerra nga auditori i brendshëm, si dhe ti sigurohen kushte optimale për përmbushjen e planeve vjetore të punës

## VIII. Dy llogaritë bankare të mirëbesimit

Si pjesë e raportit tonë mbi pasqyrat financiare 2008, kemi bërë një përpilim të veçantë për gjendjen e dy llogarive bankare të komunës së Prishtinës. Sipas informative që disponojmë, këto dy llogari bankare janë hapur në vitin 2000 me autorizim të administratorit të atëhershëm të UNMIK-ut për komunën e Prishtinës .

Në bazë të raporteve bankare shuma e mjeteve në llogarinë parë deri më datën 31/12/2008 ka qenë €220,967, ndërsa në të dytën €179,785. Gjithsej mjetet nga këto dy llogari deri më 31/12/2008 janë mbledhur në shumë prej €400,752.

Në vijim do të japim një pasqyrë të shkurtër për këto llogari bankare :

- Llogaria e parë bankare e Komunës së Prishtinës 100065-1910-000-297 e hapur më 16.06.2000. Prej vitit 2000 deri në vitin 2004 janë grumbulluar në emër të depozitave dhe transfereve në shumë prej €683,391 ndërsa prej vitit 2003 deri në vitin 2008 në emër të hyrave nga interesi janë regjistruar shuma prej €27,195 Gjatë vitit 2000 dhe 2002 ka pasur tërheqje të mjeteve në të gatshme në shumë prej €190,907 ndërsa në vitin 2005 janë bartur mjete nga llogari të Thesarit shuma prej €301,936 në llogari të Komunës;
- Llogaria e dytë bankare e Komunës së Prishtinës 10006519-10000-103 e hapur në Nëntor të vitit 2000. Gjatë viteve 2000/2001 në këtë llogari bankar janë grumbulluar në emër të depozitave si pagesa për lokalet e shitura në vlerë prej €162,095 si dhe të hyra nga interesi në shumën prej €18,573 ndërsa nga kjo llogari ka pasur dalje në emër të interesit ndaj bankës dhe tërheqje në të gatshme në shumë prej €1,377.

### Konkluzion

- Në bazë të analizës së transaksioneve dhe testimit të mostrave kemi vërejtur se këto mjete janë grumbulluar në emër të hyrave të ndryshme si nga qiraja, tatim në pronë, të hyra nga interesi etj. Në bazë të dhënave të raporteve bankare dhe informatave të marra nga drejtori i Thesarit kemi vërejtur shuma prej €301,395 është derdhur në llogari të Thesarit në bazë të dëshmimeve të pranuar nga Komuna. Për tërheqjet e parasë që janë bërë në vitin 2005 nuk mund të konkludojmë se si janë shpenzuar këto mjete. Këto mjetet janë tërhequr në të gatshme;

Me qëllim të verifikimit të këtyre të hyrave , kemi testuar rreth 40 transaksione sipas përshkrimit. Transaksionet e testuara dhe rishikimi i tyre rezultoi se të hyrat e mbledhura i përkasin Komunës së Prishtinës;

- Testet për llogarinë e dytë kanë rezultuar se pagesat janë bërë në emër të pagesës së lokaleve të shitura. Komuna nuk ka arritur që të sigurojë dëshmi përkatësisht kontrata në lidhje me këto të hyra të grumbulluara nga shitja e lokaleve.

## **Rekomandim**

- Në bazë të rezultateve të arritura nga testimi, analiza e transaksioneve për llogarinë e parë , rekomandojmë që mjetet në këtë llogari të barten në llogari të Komunës së Prishtinës , ndërsa mjetet e mbetura në llogarinë e dytë për shkak se Komuna nuk ka arritur që të ofroj dëshmi, rekomandojmë që mjetet të derdhën në llogari të Thesarit.

## Shtojca 1

### Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit të zbatuara nga ana e ZAP në Raportet Vjetore të Auditimit për vitin 2009 (e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është në format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. Një opinion i pakualifikuar jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranura të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistence (të qëndrueshme);
- (b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- (c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar; i
- (d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si ;nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- (a) ka patur limitime në fushëveprimin e auditimit
- (b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo complete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- (c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

**13. Opinioni i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

**14. Opinioni i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionin që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

**15. Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksione të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë të kundërt a bën të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

**16.** Është bërë zakon që ILA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinionin në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

## Shtojca II: Komentet e Komunës dhe Vlerësimet e ZAP-it

Nr. i referencës në raport	Komentet e Komunës	Vlerësimet e ZAP -it
<b>III.</b>	<b>Implementimi i rekomandimeve të viteve të kaluar</b>	
<b>Pika 4</b>	Në bazë të Udhëzimit Administrativ nga Thesari për raportime të PF në pjesën e detyrimeve dhe kontigjentave është përfshirë vlera e obligimeve të bartura, paraqitur në formë tabelare.	Auditimi ka vërejtur se në vitin 2008, komuna ka pasur shpenzime për obligime të mbetura që nga vitet të kaluara të cilat nuk kanë qenë konsistente.
<b>Pika 5</b>	Barazimet mujore bëhen me departamentin e Thesarit dhe njëkohësisht me drejtorit komunale por jo tërësisht. Kemi parasysh që këto barazime në mes drejtorive ti vejmë në linjë permanente.	Nuk është e mjaftueshme të bëhen barazime më të dhënat e SIMFK, por këto barazime duhet të bëhen të rregullta më të gjitha drejtorit që mbledhin të hyra.
<b>VII. 3.1</b>	<b>Të hyrat</b>	
<b>3.1 Të hyrat ( Pika 3.1.3)</b>	Shuma e shprehur është në kuadër të përfshirjes së të hyrave. Kthimi i mjeteve në raste specifike (vendime nga gjykata, gjobat retroaktive etj) është verdik arbitrar dhe vetëm përmes Thesarit vërehen ndryshimi në emër dhe llogari të komunës.	Paraprakisht komuna duhet të vërej me kohë, se një e hyrë i përket apo nuk i përket Komunës dhe në rastet kur paraqiten gabime të bëhet kërkesë pranë departamentit të Thesarit për korigjim.
<b>3.1.1 Të hyrat nga tatimi në Pronë (Pika 3.1.1.1)</b>	Si pasojë e xhirollogarive të hapura në vitin 2002/2003 kanë ekzistuar raste kur pagesat e obligimeve tatimore të qytetarëve janë depozituar gabimisht në llogarit e komunave jopërkatese. Dhe nga kjo janë krijuar peripeci në kthimin e mjeteve në llogarinë e duhur si realizim pagese.	Për gabimet e ndodhura është e qartë, por ne kemi vërejtur se asnjë barazim në mes departamentit të tatimit në pronë dhe departamentit të financave nuk është bërë. Prandaj, rekomandimi ynë mbetet i pa ndryshuar.
<b>3.1.3 Të hyrat nga Licencat për Biznes (Pika 3.1.3.1 )</b>	Ligji mbi Shoqëritë Tregtare rregullon formën e regjistrimit të bizneseve. Ndërsa komunat i ngarkojnë bizneset për leje pune në bazë të veprimtarisë që ushtrojnë në territorin e komunës. Kuvendi i Komunës vit pas viti e rishikon dhe aprovon rregulloren për tarifa dhe ngarkesa, e cila çertifikohet nga MEF-I, si bazë juridike për arkëtimin e mjeteve nga taksa për leje pune.	Komenti i Komunës nuk adreson ndonjë papajtueshmëri me të gjeturat e auditorit, prandaj mendojmë se rekomandimet tona duhet të jenë bazë e mire për të përmirësuar procedurat dhe kontrollin e brendshëm në procesin e dhënies së lejeve të punës për biznese.
<b>3.1.4 Të hyrat nga Lejet e Ndërtimit</b>	Dinamika e pagesave brenda periudhës së caktuar sipas Rregullores ka raste konkrete që banka nuk e përcjell produktin e vet të lëshuar më	Komuna nuk ka përcjellur pagesat e kompanive të cilët kane aplikuar për leje

<b>(Pika 3.1.4.1-2)</b>	parë si garancion bankar për përmbushjen e obligimeve. Është parashikuar që në të ardhmen direkt të njoftohet AQBK-ja për rastet të cilat nuk po i përmbushin obligimet.	ndërtimi. Kjo është konsideruar si kontroll i dobët për komunën.																														
<b>3.3</b>	<b>Mallrat dhe Shërbimet</b>																															
<b>3.3.1 Shpenzimet e karburanteve (Pika 3.3.1)</b>	<p>Harxhimi i karburanteve përfshin Administratën, Arsimin Shëndetësinë, Zjarrëfiksat dhe ZLK. Shpenzimi i karburanteve është përcjell me trendë të ndryshme të çmimit blerës. Ndryshimet globale reflektojnë çmimin kushtues të karburanteve që në disa raste është bërë ribarazimi për shkak të tregut evolues të bursës. Pjesa më e madhe e harxhimit të karburanteve është dedikuar për ngrohje nëpër shkolla fillore dhe të mesëm. Sipas paraqitjes tabelare kemi :</p> <table border="1" data-bbox="453 548 1276 797"> <thead> <tr> <th colspan="2"></th> <th>2007</th> <th>2008</th> <th>%</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Nr</td> <td>Administrata</td> <td>75,242</td> <td>63,341</td> <td><b>-15.81</b></td> </tr> <tr> <td>1</td> <td>Arsimi</td> <td>8,238</td> <td>16,613</td> <td><b>101.66</b></td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Zjarrëfikësat-Prishtinë</td> <td>22,690</td> <td>20,667</td> <td><b>-8.91</b></td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>Zjarrëfikësat-Ll. Sellë</td> <td>10,480</td> <td>6,333</td> <td><b>-39.57</b></td> </tr> <tr> <td colspan="2">G j i t h s e j</td> <td>116,650</td> <td>106,954</td> <td><b>-8.31</b></td> </tr> </tbody> </table>			2007	2008	%	Nr	Administrata	75,242	63,341	<b>-15.81</b>	1	Arsimi	8,238	16,613	<b>101.66</b>	2	Zjarrëfikësat-Prishtinë	22,690	20,667	<b>-8.91</b>	3	Zjarrëfikësat-Ll. Sellë	10,480	6,333	<b>-39.57</b>	G j i t h s e j		116,650	106,954	<b>-8.31</b>	Komuna duhet të caktojë normative për shpenzimet e karburanteve për automjetet e saj. Nuk kemi vërejtur se ka procedura të mirëfillta për shfrytëzimin e automjeteve.
		2007	2008	%																												
Nr	Administrata	75,242	63,341	<b>-15.81</b>																												
1	Arsimi	8,238	16,613	<b>101.66</b>																												
2	Zjarrëfikësat-Prishtinë	22,690	20,667	<b>-8.91</b>																												
3	Zjarrëfikësat-Ll. Sellë	10,480	6,333	<b>-39.57</b>																												
G j i t h s e j		116,650	106,954	<b>-8.31</b>																												
<b>3.3.2 Furnizimi me naftë për shkolla</b>	<p>1. Për rastet e kontratave për furnizime nuk është i obliguar sigurimi por për kontrata për punë... shiko nenin 60.1 Edhe neni 60.2 ka të bëjë me të njëjtën çështje.</p> <p>2. Lidhur me çmimin e berëzës, Komuna është shërbyer me çmimin e nxjerrë nga APP dhe konsideroj se kjo është e mjaftueshme dhe kredibile.</p> <p>3. Lidhur me faktin se premiumi i kompanisë fituese është shumë i ulët, është e saktë por kjo është në pajtim me kriteret e dosjes së tenderit me të cilat është përcaktuar kriter bazë çmimi më I lire. Kompania fituese HIB Petroll njihet ndër kompanitë më prestigjioze në Kosovë për furnizime me naftë. Premiumi më i ultë është në dobi të AK.</p>	<p>Auditori të gjeturën e tij e ka bazuar në</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Nenin 11 të kontratës, përkatësisht të kushteve të veçanta, në të cilën është parapa garancioni në vlerë prej €92,866 dhe kohëzgjatje prej 6 muajsh.</li> <li>- Nenin 60.2 të LPP-së, përkatësisht në rreziqet e mundshme që do të mund të pasojnë në natyrën e kontratës afatgjate për naftë.</li> </ul> <p>2. Sa i përket çmimit të naftës, sipas berëzës, auditori ka identifikuar si të gjetur mungesën e dëshmimeve për nxjerrjen e këtij çmimi, si dhe autoritetit kompetent për këtë çështje.</p> <p>3. Në lidhje me premiumin e kompanisë Komenti i Komunës nuk adreson ndonjë papajtueshmëri me të gjeturat e auditorit,</p>																														

		prandaj mendojmë se rekomandimet tona duhet të jenë bazë e mirë për të përmirësuar kontrollin e brendshëm në fushën përkatëse.
<b>3.5</b>	<b>Investimet Kapitale</b>	
<b>3.5.1. Ndërtimi i objektit të Komunës, vlera €2,179,578</b>	<p>Auditori raportin e auditimit të kompanisë fituese nuk e vlerëson të plotë dhe e vë në kontest me kompaninë më të lirë të eliminuar. Dua të sqaroj se raporti i auditimit i kompanisë fituese është i punuar nga një auditor i licencuar, në pajtim me ligjin ndërsa kompania e eliminuar ka pasur disa mangësi substanciale të renditura nga komisioni i vlerësimit si më poshtë;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ka munguar raporti i auditimit;</li> <li>• Është kërkuar qarkullim min. €3,000,000. ndërsa kompania e eliminuar ka pasur punë të kontraktuara €2,744,095. ndërsa transaksione bankare vetëm €2,275,662 që është në kundërshtim me pikën III.1.3. të kriterëve të dhëna në dosjen e tenderit;</li> <li>• Kompania e eliminuar nuk ka pasur licencë për punimet e elektrikes dhe klimatizimit si dhe</li> <li>• Ka pasur shmangie materiale të shprehura si gabime aritmetike nga vlera e lexuar €1,828,377 në çmimin real €1,902,398 apo mbi €74,000.</li> </ul> <p>Pra, baza e eliminimit ka qenë shumë më e arsyeshme se që aludon auditori. (shiko shtesën e raportit të vlerësimit dhe shkaqet e eliminimit).</p>	<p>Auditori ka konfirmuar me saktësi Dokumentin e quajtur Raporti i Auditorit, të Operatorit fitues, para se të arrij të konkluzioni përfundimtar. Ky dokument përmban vetëm Pasqyrat financiare të vulosura dhe nënshkruara nga auditori, që në formatin standard, nuk është Raporti i auditimit, ngase nuk është dhënë opinion për ato Pasqyra, nuk janë bërë shpalosje dhe nuk janë ofruar informata të tjera raportuese të auditorit. Ne mund të ia dëshmojmë Komunës mangësitë serioze të raportit të auditorit përmes dëshmime që kemi mbledhur.</p> <p>Të gjeturat tona kanë të bëjnë me jo përgjegjshmërinë e OE fitues, ndërsa OE me i lirë ka qenë vetëm një shembull krahasues për përdorimin jo të drejtë të të njëjtit kriter të përcaktuar nga vet komuna.</p>
<b>3.5.3. Ndërtimi I rrugës Slivovë-Viti e Marevcit, vlera €1,304,465</b>	<p>Është zgjedhur oferta më e përgjegjshme, në pajtim të plotë me kriteret e dhëna në dosjen e tenderit ndërsa në kohën e auditimit dosja nuk ka qenë e kompletuar sepse edhe projekti ka qenë i pa përfunduar. Me përfundimin e projektit, dosja kompletohet në tërësi. Rekomandimi I auditorit është qëllim mirë.</p>	<p>Ky projekt ka qenë bashkëfinancim në mes komunës dhe MTPT-se. Dosja e tenderit ka qenë jo complete sepse shumë prej fletëve të saja mungonin. Prandaj, obligim i komunës mbetet që për çdo projekt të disponoj me dosje complete.</p>
<b>3.5.4. Ndërtimi i rrugës Ballaban-Keqekollë, vlera €444,283.</b>	<p>Në pajtim me stafin menaxhues të Komunës, periudha kur nuk ka kushte teknike për kryerjen e punëve nuk merret si periudhë ndëshkuese ndërsa për periudhën tjetër janë marrë masa ndalesë në pajtim me kushtet e kontratës. Ndaj të njëjtit Operator Ekonomik si</p>	<p>Komuna nuk ka paraparë dhe nuk ka specifikuar se cilët muaj në rast vonese nuk do të llogariten ndalesa prej 0.05%.</p>



	masë ndëshkimi është marrë edhe mos-shpërblimi me kontrata tjera nga AK për periudhë kohore të caktuar që konsiderojmë si masë ndëshkuese dhe preventive.	
<b>3.5.5. Ndërtimi I QMF në Lagjen Vreshtat dhe në Velani në vlerë €176,652.</b>	Pajtohemi me konkluzionet e auditorit se raportet për punët e kryera gjegjësisht situacionet duhet të kompletohen më mirë për të qenë dëshmi reale e gjendjes kur bëhet pagesa dhe kjo në të ardhmen do të bëhet siç duhet.	Rekomandimi mbetet.
<b>3.5.6. Punët shtesë në projektin Shkolla fillore në Lagjen Vreshtat, vlera €27,650.</b>	Ka qenë ndër projektet më të ndërlikuara për realizim. Në pajtim me praktikën e Agjencionit të Prokurimit, negociimi duhet të kryhet më parë e pastaj ai organ lejon punët shtesë. Zyra e Auditorit ka vërejtur patjetër se rastet e punëve shtesë në komunën e Prishtinës janë krejtësisht simbolike në krahasim me numrin e aktiviteteve të prokurimit dhe ato janë lejuar vetëm atëherë kur një gjë e tillë ka qenë e domosdoshme. Rasti i shkollës së përmendur është analizuar detalisht duke përfshirë edhe çështjen e çmimeve të negociuara nga një ekip e veçantë. Faktet e ofruara prej tyre kanë qenë bindëse edhe për APP që ka lejuar ato punë shtesë. Nuk qëndron fakti se te punët shtesë ka ardhur si pasojë e neglizhencës së AK, përkundrazi me angazhimin e lartë profesional AK ka bërë të mundshëm realizimin e një projekti voluminoz prej mbi 8000 m <sup>2</sup> në një lokacion shumë të pa përshtatshëm për punë që karakterizohet me teren me pjerrtësi shumë të madhe, burime të ujërave nën-tokësore dhe hapësira të mbushura me mbeturina të ngurta para më shumë se 30 viteve. Pra, kompleksiteti I objektit ka determinuar punë shtesë, që është ndër rastet e pakta që ndodhin me projektet e realizuara nga Komuna e Prishtinës.	Paraprakisht punët shtesë që i përkasin periudhës 2008 dhe për te cilat është vënë theksi nuk kanë të bëjnë me pozicione përdhese që ndërlidhen me kompleksitetin e lokacionit të pa përshtatshëm, por me pozicione kulmi. Gjithashtu, Auditori nuk ka të njohur praktika të Agjencionit të Prokurimit, përmes së cilave negociimi duhet të kryhet me parë e pastaj ai organ lejon punët shtesë. Baza ligjore rregullon që paraprakisht ti kërkohet Agjencionit të Prokurimit që ajo të ua lejoj negociimin e punëve shtesë. Si mund të shpjegohet fakti se pas aprovimit për përdorim të procedurave të negociimit Drejtori i Agjencionit të Prokurimit në secilin rast kërkon që Autoriteti Kontraktues tu përmbahet kërkesave të nenit 30.9.
<b>Përfundim</b>	Komuna e Prishtinës, si njësi buxhetore përkrah rekomandimet e dhëna nga ZAP në draft raportin e auditimit të bërë për periudhën 01/01/2008 deri më 31/12/2008, duke mirëpritur se edhe komentet e dhëna nga menaxhmenti i komunës së Prishtinës do të inkorporohen në raportin final.	ZAP mirëpret dhe vlerëson bashkëpunimin në mes dy institucioneve dhe njëkohësisht admiron përkushtimin e K. Prishtinës për zbatimin e rekomandimeve të dhëna. Ne do të vlerësojmë zbatimin e këtyre rekomandimeve gjatë auditimit të pasqyrave financiare të vitit 2009.